

JONATHAN BAZZI

ETHET

ROMAN

BOTIMET TOENA

JONATHAN BAZZI

ETHET

roman

Përktheu nga origjinali italisht
Erion Gjatolli

BOTIMET TOENA

Tiranë, 2022

Autori: Jonathan Bazzi (Xhonatan Baci)

Titulli në origjinal: Febbre

Botoi në italisht: Fandango Libri s.r.l



Me bashkëfinancimin e Programit
“Europa Krijuese” të Komisionit Europian.

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Redaktore: Diana Çuli

Korrektore letrare: Eglantina Hilaj

Përkujdesja grafike: Edona Marku

© e imazhit në kopertinë: Daniela Xhetani

ISBN 978-9928-348-67-8

© 2019 by Fandango Libri s.r.l

© *në shqip* Botimet Toena

BOTIMET TOENA

Rr. “M. Gjollësja”, K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: botimet.toena@gmail.com

toena.porosionline@gmail.com

www.toena.al

Fëmijëve të padukshëm

*Çdo lidhje dashurie, edhe më e guximshme, e njeh frikën
nga duhet të ruhet, domethënë të fjalëve që nuk duhen thënë,
argumenteve që nuk bën të përmenden.*

Elsa Morante, “Mashtrim dhe magji”

Me dorën time të djegur shkruaj për zjarrin.

Ingeborg Bachman

Tri vite më parë më filloi temperatura dhe nuk m'u ul më

Tri vite më parë më filloi temperatura dhe nuk m'u ul më.
11 janar 2016.

Ende nuk i kam mbushur tridhjetë e një vjeçët.

Kthehem në universitet: është vakt dreke, por nuk kam uri.

Çfarë ke?

Nuk ndihem mirë, mund të kem pak temperaturë.

Ulem në divan, as libër nuk lexoj dot.

Ethet më fillojnë me të vërtetë.

Nuk bie më.

Një javë, dy javë.

Një muaj.

38, 38 e gjysmë, pastaj bie pak, por nuk lëviz më.

37.4, 37.3, nuk ndalet, nuk bie.

Kolonë merkuri që i kanë bërë magji.

E ul.

Ngrihet përsëri.

Sa herë që heq termometrin nga sjetulla shpresoj të ketë rënë. Nuk bie. Gjithmonë pak mbi 37, kufiri, vija ndarëse - mes atij që isha dhe këtij që jam.

Kthehem në universitet dhe mat temperaturën. E mat përsëri, gjithmonë, edhe një herë.

Më merr në telefon mamaja, fillon të më marrë çdo tri orë.

Ke akoma temperaturë?

Po, mami, kam akoma.

Po si ka mundësi? Mate prapë më vonë.

Mate vazhdimisht. Mos e lër kurrë pa matur.

Çdo dy orë më pyet sa e kam.

Tachipirina nuk më bën asgjë: ulet dhe ngrihet përsëri.

Tri ditë, pesë, dhjetë.

Shkoj të jap leksion edhe pse nuk ndihem mirë - jap kurse joge në palestër prej katër vitesh (apo u bënë pesë?). Në fillim më pëlqente, tani jo më. Detyrohesh të bëja shumë kurse, kudo, në çdo orë. Palestra, shkolla baleti, qendra dobësimi - cilësia sipas rastit, më së shumti e dobët. Këtë punë bëja gjatë universitetit. Pranoja çdo telefonatë, propozim, zëvendësim, edhe kur nuk kisha aspak dëshirë.

Po nuk shkova nuk më paguajnë, duhet të shkoj edhe me ethe.

Kontratë nuk kam, jam i vetëpunësuar: nuk pranohet sëmundja, as lejet. Nesër kam mësim herët në mëngjes, duhet të dal nga shtëpia që në shtatë. Mendova se do të bëhesha pak më mirë. Tani është vonë për të njoftuar. Përgjegjësi i kurseve është i ri, po lë pa punë shumë instruktorë. Do të bjerë në sy me shefat e vet: të thërret, të kërcënon, të shkurton orët. Dihet që në Milano ka më shumë instruktorë sesa njerëz që bëjnë joga - është biznes kjo puna e instruktorëve - po të dojë të zëvendëson në çast.

Natën djersitem shumë.

Kur zgjohem, shtrati është i njomë nga djersa e gjumit. Një njollë e zezë mbi çarçafin blu, me përmasat e mia. Një njollë e zezë me formën time.

Edhe jastëku është i njomë. Lag njëren anë, e kthej dhe lag edhe tjetrën.

Ngrihem dhe ndërrohem, deri në tri bluza përpara agimit. Këtë e tutje kështu do të jetë: natën trupi shembet në një pellg uji. I dorëzohet temperaturës së marrosur, që ngrihet, bie, bën çfarë të dojë.

Zgjohem, bëj dush, bie përsëri në gjumë në divan, pa dashur. Djersitem përsëri, zgjohem, dal në shtatë, me vonesë, qull.

Vajti ora: zbres në rrugë. Janar, Milano, mund të jetë dy gradë. Ajri i akullt më hyn nën pallto, ma ngrin djersën. Do të doja të ndalesha, të kthehesha në shtëpi. Mbulohem edhe më shumë, vë kapuçin, mbroj kokën. Eci ngadalë, i mbështjellë me pallton dhe me djersën e ngrirë. Hap pas hapi.

E shpejtoj dhe e ngadalësoj hapin.

Dua të di çfarë kam.

Rrugë, kryqëzim, pastaj metro, duhet të ulem.

Ndaloj. Nuk mundem më.

Ngadalësoj frymëmarrjen, mbush kafazin e kraharorit: duhet ta marrësh veten.

Arrij në palestër, ndërrohem, ngjitem në sallë. Po më presin, jam me një çerek ore vonesë. Leksioni zgjat pesëdhjetë minuta. Me siguri do të jenë ankuar te recepsioni.

Kërkoj falje, e them, e pranoj: jam pa qejf.

Thamë se nuk do të vije fare.

Buzëqesh.

Çfarë dreqin doni.

Zonjat që vijnë për leksionin tim janë mësuar të më shohin që kaloj me lehtësi nga një pozicion në tjetrin. Me trup të përkulshëm, të fortë, pothuajse prej sportisti. *Çfarë paska sot? Si e ka ballin?* Kërkoj falje, por më pas nuk e përsëris më këtë. Nuk kërkoj më ndjesë, bëj sikur nuk ka ndodhur asgjë. A ndryshon gjë?

Në ditën e katërt me ethe, mamaja fillon të marroset. Një vajzë kështu filloi - më thotë në telefon - me pak temperaturë. Brenda javës vdiq.

Meningjit akut.

Shko te mjeku, çfarë pret? Apo të jetë shumë vonë?

Më merr vazhdimisht në telefon. Kur nuk më merr, më dërgon mesazhe. Nëse nuk përgjigjem menjëherë, më dërgon një tjetër dhe pastaj përsëri, përsëri, dhjetëra e dhjetëra: frika e saj përhapet përmes fushës elektromagnetike të celularit, bëhet e imja. Kështu ka ndodhur gjithmonë.

Shko te mjeku, të të vizitojë.

Unë nuk kam as mjek. Kisha atë të përkohshmin, deri vitin e kaluar. Një nga ata që të caktojnë kur je student, ose kur ke vendbanim në një vend tjetër nga ai ku jeton. Pas një viti skadon, duhet të rinovohet dhe unë nuk e bëra.

Por, mamaja ka të drejtë: duhet të bëj diçka.

Mundohem t'i shkruaj një doktorit të ri që më rekomandoi Xhani, Khanfrankoja, një miku im. Është i ri, mendoj se është gej. I bën reklamë vetes në *Facebook* dhe *Instagram*. Është i fiksuar me historinë e artit, nxjerr piktura më shumë se çdo gjë tjetër. Studion mjekësi kineze, akupunkturë. Rekomandon receta vegane. I shkruaj në *Messenger*.

Ç'kemi, mund të të shqetësoj pak?

Sigurisht, me kënaqësi.

Jam pa mjek familjeje. Jam nga periferia, por kam disa vite që jetoj në Milano. Ama vendbanimin nuk e kam ndryshuar. Një miku im më këshilloi të lidhesha me ty, qoftë edhe vetëm për një mendim.

Jepi, si është puna?

Kam disa ditë me temperaturë. Ulet dhe ngrihet, por nuk kam asnjë simptomë tjetër.

Kollë, dhimbje fyti?

Jo, çdo gjë në rregull.

Urion normalisht? Del jashtë?

Po.

Mund të vish këtu nesër në mëngjes? Të vizitoj edhe pse s'të kam pacient.

Në rregull.

Mund të regjistrohesh më vonë te Drejtorja Shëndetësore Rajonale. Do të jem në studio nga ora 10:00 deri në 12:30. Eja të shohim si është puna, që të kthehesh në shtëpi i qetë.

Unë dhe mami jemi vetëm kur vijmë e na trembin

Unë dhe mami jemi vetëm kur vijmë e na trembin.

Jam një vjeç e gjysmë, prej disa muajsh jetojmë në një apartament në Rrugën e Zymbylave, numër 10.

Jemi vetëm në shtëpi, babi është në punë.

Mamit i del gjumi rreth orës katër të mëngjesit. Zhurma, diçka që përplasët. Binte shi që mbrëmë, mendon mami: me siguri është shiu ose ndonjë degë që kërcet nga era.

Jo, nuk është shiu. As era.

Mami ngrihet, shkon në kuzhinë, andej nga vjen zhurma.

Unë fle në djepin në krah të shtratit të prindërve - Ti *nuk kuptove gjë*. Bletët pezull mbi fytyrë, kukullat atje ku duhet të jenë. Nuk more vesh asgjë, mbulo, mos trego, një jetë normale kjo e jona, edhe jotja.

Grila e kuzhinës e ulur, babi i kyç nga brenda sa herë që del, për siguri. Mami nuk e ndez dritën, nuk duhet: shtylla që kemi përballë shtëpisë që na caktuan përpara disa muajsh - kati i tretë në një pallat tetëkatësh, dera në të djathtë të shkallës - e ndriçon edhe fasadën e pallatit tonë. Ndriçon ballkonin e kuzhinës.

Nga drita e shtyllës në Rrugën e Zymbylave mami arrin t'i shohë fare mirë duart poshtë grilës, teksa mundohen ta ngrenë. E shtynjë për lart. Dryni nuk e lë të lëvizë nga vendi.

Mami ndien t'i dridhen gjunjët.

O Zot, të lutem, bëje drynin të mbajë.

Sa të marr ndokënd në telefon.

Mami te pragu i kuzhinës, përpara grilës që duket gati të hapet.

Duart vazhdojnë, nuk ndalen - kanë një detyrë për të kryer - shtynjë lart me vrull grilën që duhet të na mbrojë. Duar burri, leshatore. Duart e burrit që po mundohet të hyjë në shtëpinë tonë. Thonjtë e pistë, gishta të regjur e me muskuj që bëjnë sa munden: një përbindësh, një kriminel, një përdhunues?

Mami ngre çelësin pranë derës, drita mbush kuzhinën, por burri nuk tërhiqet. Nuk ka frikë se mund ta shohin. Nëse nuk është hajdut, çfarë do nga ne?

Një nga mbërtheckat dorëzohet dhe këputet. Fluturon tutje dhe përplasat me xhamin e derës-dritare.

Duket sikur zhurma e xhamit që pothuajse thyhet e nxit edhe më shumë: nuk mbahet më, e shkund grilën edhe më fort.

Ndihmë, mami, si do t'ia bëjmë?

Mamaja e kupton që ai nuk ka ndër mend të ikë. Është gati të bëjë gjithçka, nuk ka çfarë të humbë.

Kthehet, nxiton për te telefoni që kemi në korridor. Merr gjysh Pierin, babain e babit, që banon pranë nesh.

Mami pse nuk del? Pse nuk del në shkallë, pse nuk u kërkon ndihmë fqinjëve?

Mami ka frikë se dikush tjetër mund të jetë te shkallët: ka frikë se njeriu i ballkonit nuk ka ardhur vetëm. Sa janë? Një bandë e tërë, një ushtri? Të pashpresë, ne të dy, një vajzë nëntëmbëdhjetë vjeçe dhe një fëmijë një vjeç e gjysmë. Në grackë brenda apartamentit të vogël që na ka dhënë bashkia, siç bën me të mëdhenjtë, me të rriturit. Ç'të keqe kemi bërë? Pse keni ardhur të na zgjoni, pse doni të na rrëmbeni?

Mami shtyp me nxitim butonat e telefonit, formon numrin e gjyshit.

E di përmendësh.

Zoti Pierluixhi.

Zoti Pierluxhi, më dëgjoni?

Tina jam. Zoti Pierluixhi, duan të na hyjnë në shtëpi, ejani.

Nëna Nuça merr në telefon babin, gjyshi vesh këpucët dhe zbret. Kalon garazhin, për të ardhur më shpejt ecën mes për mes kopshteve të shtëpive të pakta që na ndajnë. Rruga e Azaleve, Rruga e Begonieve, e Narciseve, e Jargavanëve. Gjyshi vrapon, vjen te ne, vjen të na shpëtojë?

Ndërkohë që gjyshi mbërrin, burri në ballkon heq dorë, ia mbath.

Dëgjoi mamën që fliste në telefon?

Vjen gjyshi, pastaj edhe babi.

Babai im - njëzet e dy vjeç - e di mirë si është puna, shkon menjëherë te Karmeloja, në katin e parë.

Babi është më se i sigurt: i thotë mamit që nuk synonin të hynin në shtëpi. Donin thjesht të na trembnin. Të na tregonin kush është i fortë i Rrugës së Zymbylave. Ai ka hapur disa probleme këtu: në rrugën tonë shesin drogë, qarkullojnë armë dhe Karmeloja është shefi, e kontrollon ai zonën. I hodhën në tokë të gjitha muret e bodrumeve për ta përdorur si magazinë për mallrat e vjedhura. Nuk kemi më bodrum. As ne, as komshinjtë në pallatet e tjera. Bodrumet e lagjes janë bërë magazina për horrat e Rocanos.

Në pallatin tonë ankohen, por nuk bëjnë asgjë.

Kujt ia mban të merret me ta...

Një ditë do të shkoj në polici - përsëritin vazhdimisht, me njëri-tjetrin. Ankohen për kantinat dhe gjithçka tjetër, por situata mund të ndryshojë vetëm kur të vdesë dikush. Mund të ndryshojë, por jo për më mirë. Thjesht vendosen rregulla të reja, tjetër hierarki. E merr drejtimin dikush tjetër.

Vazhdon të bjerë shi: kur babi dhe gjyshi arrijnë në shtëpi, ngrenë grilën e kuzhinës dhe gjejnë gjurmët e atij burrit. Ballkoni nuk është i shtruar me pllaka: derisa ta rregullojë, babi ka shtruar një mushama mbi çimento.

Mbi të kanë mbetur gjurmët e këpucëve të burrit.

Ashtu si erdhi një herë, mund të vijë prapë: mami e di, ia thotë edhe babit.

Roberto, unë nuk rri më vetëm në këtë shtëpi, ç'na ka dhënë kështu bashkia?

Mos ki merak, Tina, merrem unë me këtë punë.

Nuk do t'ju ndodhë gjë. Të jap fjalën.

Si ndihesh?

Si ndihesh?

I plogësht, i pafuqi, si në gjendje gripi.

Kushdo që më pyet, ia kthej me të njëjtët tre a katër mbiemra. Të pasaktë, të vagullt, të pafuqishëm.

Mjaft, e mblodha mendjen: do të shkoj të vizitohem.

Hipi në metro, me drejtim Seston, për të takuar doktorin tim të ri në studion mes rrugëve “Monza” dhe “Padova”. Pres në një karrige të viteve shtatëdhjetë, gri e vjetruar dhe e rrjepur: po viziton një vajzë afrikane që nuk e flet mirë italishten. Ka një problem gjinekologjik. Po i rezervon një vizitë me një specialist.

Më kupton çfarë po them?

E ke takimin nesër.

E gjen dot rrugën?

Vajza mbledh gjërat e saj dhe del.

Kush e ka radhën?

Sapo hyj në dhomë, doktori im i ri më thotë se nuk jam i hidratuar. Më ul në shtrat, më shikon sytë, lëkurën: e shikon sa të thata i ke buzët? Ke pirë mjaftueshëm? Xhenxhefil, kurkuma, bëj ndonjë çaj.

Kam një javë me ethe, asnjë simptomë tjetër.

As rrufë, as dhimbje fyti.

Trupi duhet të shërohet vetë, më thotë, nuk të jap antibiotik.

Më jep integrorë, hape me vitamina, çaj me rrënjë *echinacea*.

Shkoj t'i blej në farmaci. Me këto me siguri do të bëhem mirë. Kur kthehem në shtëpi u bëj edhe fotografi. Ngërthej në një foto imazhin e këtyre katër a pesë shisheve të vogla përpara dritares së kuzhinës. Vendosur në rresht, njëra pas tjetrës, mbështjellë nga një dritë e bardhë - është ogur i mirë, shtoj edhe një filtër për ta rritur efektin.

Një terapi natyrore do të më shpëtojë.

E pavërtetë, nuk më bën asgjë.

Temperatura vazhdon.

37.3, 37.4.

Nuk shpërthen, por as nuk fiket.

Mbetet atje, nga mëngjesi deri në darkë.

Mat temperaturën, *e ke matur temperaturën?* Shtrat, divan, pastaj sërish shtrat. Mamaja më merr në telefon: nuk dua t'ia them që nuk më ka rënë akoma. Që është ende këtu, njëlloj si më parë. Nuk është grip, tani duhet ta pranoj, nuk është grip i zakonshëm.

Filloj të kërkoj në Internet simptomat dhe shkaqet. Ç'sëmundje të jetë kjo që më ka zënë?

Dal nga shtëpia sa më pak të mundem. E detyroj veten të shkoj në palestër për leksionet dhe për të bërë pazar vetëm kur është e domosdoshme. Pjesën tjetër të kohës e kaloj në divan dhe kërkoj hipoteza *online*. Duhet të kuptoj, duhet ta di çfarë kam.

Ethe të vazhdueshme, kështu i quajnë, lexoj se paska një emër të veçantë për temperaturën pak më të lartë, por të lehtë dhe të përhershme. Kërkoj në *Google: temperaturë që nuk ikën, temperaturë pak e lartë e vazhdueshme. Konstante*. Lexoj në faqe *web*, forume, konsulta *online* me mjekë. *Ethe të lehta, temperaturë 37 prej dy javësh*. Ka njerëz që kanë temperaturë të tillë dhe nuk u ka zbritur më, si ndonjë sindromë. Lexoj dëshmitë e atyre që e kanë pasur

apo e kanë ende: temperaturë me origjinë të panjohur, *Fever of Unknown Origin* - F.U.O. Ka edhe raste shumë më të rënda, njerëz që më pas çfarë nuk u ka ndodhur.

Kam frikë, filloj të kem vërtet frikë.

Ndonjë absces i fshehtë, një infeksion, tiroidet, tumor?

11 janar 2016, kthehem në universitet dhe më ngrihet temperatura.

U ktheva në këmbë, edhe pse që në seminar nuk ndihesha mirë.

Universitetin e kam dhjetë minuta nga shtëpia, nuk mora metronë - u bëra pishman. Është ora e drekës, duhet të ha, por nuk kam oreks. Në kursin e filozofisë që sapo filloi, profesoresha nisi të tregojë mësimjen e athinasve në ishullin Melos për të vërtetuar se masat e rëndësishme në politikë janë ato që bazohen në marrëdhëniet e forcës.

Mundohem të shoh shënimet, por më djegin sytë. Nuk mundem. Kam temperaturë, nuk do të më kalojë kurrë. Nuk shkoj më në universitet. Nuk shkoj të nesërmen, nuk e ndjek më kursin. Nuk shkoj as një ditë më pas dhe nuk do të shkoj as më tej.

Nuk do ta marr diplomën.

E hënë, 11 janar: në datën 8 kishte ditëlindjen Mariusi, i dashuri im. Kemi tre vjet që jetojmë bashkë. Unë, ai, Manaferra dhe Pureja, dy macet *devon rex* që morëm me Markon, ish-të dashurin tim (unë do t'i kisha quajtur Rozaspina dhe Leon, ishi im Korba dhe Ditëziu, gjetëm një kompromis).

Të shtunën në darkë, për të festuar ditëlindjen e Mariusit shkuam të kërcenim me miqtë e tij. Në fakt, më parë shkuam të pinim në disa lokale këtu afër dhe pastaj në diskotekë. Nuk ndihesha keq, ndoshta vetëm pak i lodhur. Gjëra të vogla. Më kishte ndodhur edhe herë tjetër. Në diskotekë, një miku i tij,

në banjë, pasi më pa, më tha duke qeshur: nuk dukesh mirë, dukesh si sieropozitiv. Ti dukesh edhe më shumë, u përgjigja unë. Sieropozitivët që njoh unë të ngjajnë më shumë ty - tip kurvash, domethënë - sieropozitivët që njoh unë janë kurva, si ti.

Puna është që unë jam dukur gjithmonë si i lodhur: që i vogël më thoshin që dukesh i sëmurë.

Paske rrathë nën sy, sa i zbehtë je, rri pak në diell.

Ha mirë ti?

Kam edhe një video nga ditëlindja e Mariusit: në njërin nga lokalet ku shkuam përpara diskotekës e regjistrova veten duke futur në gojë një shuk me qese plastike transparente. Kisha pirë. E hodha videon në Instagram në të kundërt, në *remind*: duket sikur thith me gojë një lule të madhe qelqi të zhubravitur. Masa me shkëlqim, nga e fryrë fillon të ngushtohet, më zgjeron jashtë mase buzët. Hyn e gjitha, zhduket. Sytë e çapëlyer, lëkura e skuqur, blici i telefonit drejt e në fytyrë.

Kalojnë edhe dy ditë.

Shkoj edhe një herë te doktori im i ri.

Nuk ka njeri: studion sapo e ka hapur, pak pacientë.

Përfitoj nga gatishmëria e tij, nga nevoja që ka për t'i pëlqyer të tjerëve.

Hyj, ulem.

Atëherë, si dukesh?

Kam akoma temperaturë. Nuk shkon shumë lart, por vazhdon.

Ai nuk i jep rëndësi, mendon se e kam lënë veten pas dore: ndonjë grip, ftohje e stinës.

Po i pi integratorët? Ndoshta është mononukleozë. Zakonisht jep pak temperaturë dhe djersë gjatë natës dhe ti i ke të dyja.

Duhet bërë analizat e gjakut, pa humbur kohë. Duhet të shoh analizat që ta kuptoj çfarë infeksioni ke. Nëse është viral, siç ma merr mendja, apo bakterial.

Të nesërmen më shoqëron një miku im, Alesandro. Jemi njohur në universitet. Ai është diplomuar në histori arti dhe po fillon punë në një organizatë ankandesh. Ka fiksим sepetet e kohës së Rilindjes, që përdoreshin për pajën e nuseve. Është nga Bergamo, jeton atje me të dashurin. Vjen enkas për të më shoqëruar në spital: fle tek unë një natë më parë dhe në mëngjes herët shkojmë te poliklinika, në qendër, në rrugën “Sforza”, ngjitur me Universitetin e Milanos, ku jam regjistruar.

Dalim rreth orës shtatë. Është rrugë e shkurtër, por prapëseprapë lodhem. Më rëndon çdo hap jashtë shtëpisë, në rrugë, në spital. Nuk them asgjë, një ditë do të shërohem. E sigurt, po si?

Ndalojmë në një kafene.

Kam veshur si gjithmonë pallton e trashë ngjyrë kafe: ma ka bërë dhuratë Mariusi vitin e kaluar, sepse nuk kisha diçka të ngrohtë për dimër. Që kur jemi lidhur bashkë, pothuajse nuk kam blerë më rroba: vesh të tija. Më pëlqejnë, pastaj ai është këshillues mode. Vishem më mirë që kur jam lidhur me të. Nuk dukem më si mi bibliotekash, por pak si shoku i Hajdit. Të gjitha janë të të dyve, dollapi nuk është më imi: jemi bërë njësh edhe përmes rrobave.

Në kafene pres që Alesandro të mbarojë. Ha një *croissant*, pi një kapuçino soje. Unë duhet të jem esëll për analizat e gjakut. Pagan dhe dalim. Hapa, autobus, pak fjalë - ja, arritëm.

Në spital, në radhë për të paguar, rrëmuja më ndez, marr jetë: për të hequr mendjen nga mërzia bëj një *selfie* dhe e hedh në Instagram. Mes monitorëve të sallës së pritjes dukem si korrespondent lajmesh.

Dëgjoj bisedat e njerëzve që kam përreth.

Përhumbem mes pjesëzave të fjalive dhe përsëritjeve të recepsionistit.

E keni kartën e shëndetit?

Më falni, e keni sjellë urinën?

Në cilin muaj të shtatzënisë jeni, zonjë?

Bën 27 euro e 80.

Një çerek ore, gjysmë ore, më në fund më vjen radha.

Hyj vetëm në korridorin e dhomave të vizitave dhe të analizave. Më qëllon një infermier, mashkull, i nxituar, radioja ndezur. Ndërkohë që ulem, flet me koleget. Qeshin, bëjnë shaka, as që duan t'ia dinë që unë mund të jem sëmurë. Bota vazhdon edhe pse unë jam në rrezik - *mos bëj si viktimë*. Por është e vërtetë: për të sëmurin, gjendja e vet ka rëndësi absolute. Enigma që do të duhej të ndalonte rrjedhën e kohës, jetën e të tjerëve. Sëmundja veçon, ndan, izolon atë që e bart në një fluskë më vete - egoiste, e trembur - e risjellë tek uni-im parak që nuk sheh gjë tjetër veç vetes.

Me nxitim, pa më thënë asnjë fjalë, infermieri më lidh lakun hemostatik në krah. Kthej kokën në anën tjetër për të mos lidhur ndjesinë e gjilpërës që shpon lëkurën dhe hyn në krah me imazhin e mishit tim të shpuar dhe të gjakut që më nxjerrin nga trupi.

Nuk kam frikë, thjesht nuk dua t'i bëj bashkë këto dy gjëra. Nuk dua të shoh ndërkohë që ndodh.

Infermieri, gjithmonë pa thënë asnjë fjalë, nxjerr gjilpërën nga krahu. Pranoje: nuk të takon asgjë tjetër veç kësaj përsëritjeje mekanike. Mënyra se si veprohet këtu, protokollit: mbaruam, mirupafshim, kush e ka radhën?

Nuk ma ka bërë mirë injeksionin: ndërkohë që kthehem tek Alesandro - vazhdon të qëndrojë ulur përballë recepsionit -

poshtë pambukut të fiksuar me ngjitës letre rrjedh një pikë gjak që më përshkon pjesën e brendshme të parakrahut dhe zgjatet poshtë, deri te kyçi. E fotografoj, është e bukur: një vijë e kuqe e errët që pak nga pak fillon të zbehet, humbet dendësinë, aq sa mund të dallohet edhe ngjyra e lëkurës.

E kremtoj me këtë foto fundin e mëngjesit.

Tani thjesht duhet të pres.

Pastrohem, marr diçka nga aparatet automatike. Një çaj të ngrohtë, me shumë sheqer. Një ëmbëlsirë çfarëdo, nuk kam aspak dëshirë të zgjedh. Fiksimet e mia për ushqyerjen e shëndetshme nuk kanë më vlerë. Kanë dështuar.

Kthehem në shtëpi dhe mat temperaturën.

Fle disa orë.

Zgjohem, mat temperaturën.

Asnjë ndryshim.

Merkuri konfirmon.

Po ndodh me të vërtetë.

Jam rritur në Rocano, kodi postar 20089

Unë jam rritur në Rocano, kodi postar 20089, një qytezë e vogël, por ndoshta jo edhe aq shumë, në periferinë e skajit jugor të Milanos, ndërtuar në mes të fushave që shtrihen në krah të “Naviglio”-s , në drejtim të Parias.

Buçinasko, Korsico, Asago, Rocano: vende nga vijnë shumë reperë dhe lajme krimesh. Të shtënat, grindjet ku dikush plagoset ose humb jetën, bandat e adoleshentëve, ndërhyrjet e mafies.

Diçka më pak se 43 mijë banorë në Rocano, ngjeshur pranë krahut perëndimor të unazës. Bronksi i Italisë Veriore: vendi i drogaxhinjve, punëtorëve, shpërndarësve të drogës. Katundarët, kriminelët, njerëzit në monitorim nga shërbimet e asistencës sociale. E vërtetë? E pavërtetë?

Çfarë tjetër?

Turp të të vijë, në Rocano jetojnë njerëz të mirë.

Kujdes se çfarë shkruan, mos harro që ne vazhdojmë të jetojmë këtu.

Rocano, ose *Rocanxheles*, nuk e di a e keni dëgjuar ndonjëherë: dallohet shumë lehtë edhe nga larg. Në vitin 1990 i vunë në mes, si pykë, kullën gjigante të Telekomit. Një ndërtesë shumë e lartë, 187 metra, që spikat mbi gjithçka tjetër dhe natën zhduket: mbeten vetëm dritat - disa fikse, të tjera fiken e ndizen - prandaj duket si një UFO që dallohet edhe dhjetëra kilometra larg.

Kulla e Rocanos, vendi nga ku vij unë.

Shiko, kulla, *pothuajse* arritëm.

Rocano është Milano, por nuk është Milano.

Ka pallate të larta dhe banesa sociale me ngjyra të zbehta. Shumë, jashtëzakonisht shumë, njëra pas tjetrës. Bezhë, gri, e gjelbër, e verdhë e shpëlarë, ngjyrat e shtëpive ku jam rritur. Apartamente të prodhuara në seri - dy, tri apo katër dhoma - të vendosura në rresht, njëra krah tjetrës, që formojnë pallatet e EBL-së, Entit të Banesave të Lombardisë. Tetë kate, ose trekatër për pallatet më të ulëta. Shtëpi si zgjoje, një apartament i ngjeshur pas tjetrit. Një familje mbi tjetrën, së bashku krijojnë organizmat e shënuara nga një rrugë dhe një numër.

Rrugët që dredhojnë mes pallateve të Rocanos kanë të gjitha emra lulësh - Rruga e Karafilave, Rruga e Lulemineve, Rruga e Jargavanëve - pak a shumë e njëjta logjikë sipas së cilës lagjet periferike të Rios janë të gjitha me ngjyra dhe nga larg duken si parqe lojërash.

Qira të ulëta, shtëpi që kushtojnë pak, ndonjëherë fare pak, varet nga të ardhurat e banorëve. Kur mbetëm vetëm, mamaja paguante rreth pesëdhjetë mijë lireta në muaj. Por shumë të tjerë nuk e paguajnë fare qiranë dhe *kanë shpëtuar*, janë abuzivë.

Shumë njerëz në Rocano janë me origjinë nga Jugu, por Rocano nuk është jug. Është njëfarë Jugu pa ngrohtësinë e Jugut. Është Jug i çrrënjosur dhe i mbjellë edhe njëherë me nxitim. Një shumatore e vështirësive të periferive të vogla të Kalabrisë, të Sicilisë, të Puljes, të Kampanias, i shartuar mes të ftohtit dhe mjegullës të Ultësirës së Padanias, mes ritmeve dhe standardeve të saj. Është Jug i ftohur, pa det, pa familje, pa traditat e dikurshme. Është forca e tij e vrullshme dhe kafshërore e përmbysur në negativ, e uritur, e burgosur brenda atyre pallateve në seri pa botë përreth.

Rocano është Jug i rrëmbyer, i pezmatuar, i pafre.

Në Rocano ka zënka të vazhdueshme, madje mund të vrasësh e të të vrasin.

Ka ndodhur më parë, do të ndodhë përsëri.

Një tip bën fjalë në park me disa të njohur. Borxhe droge, thanë më pas. Largohet, ikën. Shkon në shtëpi, merr revolen që mban të fshehur në dollap. Kthehet te parku mes pallateve dhe qëllon. Është ora dhjetë e mbrëmjes. Në Rrugën e Murrizave vdesin katër vetë.

Vdes një pensionist, sepse i pushoi zemra.

Vdes një vajzë as tre vjeçe, sepse e goditi një plumb qorr në qafë.

Quhej Sebi, Sebastiana.

Ishte vajza e fqinjëve tanë.

Rocanon e përshkon uji: rrjedha të vogla lumenjsh që ngjajnë më shumë me kanale shkarkimi, prani të egra, për disa shumë shqetësuese. Vendgrumbullime mbeturinash dhe pislleqesh, në brigjet e të cilave mund të shohësh bretkosa, minj dhe plehra. Pak kohë më parë, nga këto rrjedha uji doli edhe një kufomë. Një i pastrehë, shkruan gazetata, një shtetas bullgar pesëdhjetetëvjeçar. Pas dy ditësh edhe një tjetër: një grua e re, shumë e dobët, ngecur mes degëve dhe gjetheve. Një e droguar që kishte rrëshqitur në ujë?

Rocanoja është e lashtë, ka ekzistuar që në kohën e romakëve, por qyteza që shohim sot është ndërtuar më së shumti në vitet gjashtëdhjetë dhe shtatëdhjetë. E ngritën nga dheu, mes fushave dhe orizoreve.

Më thoshin gjyshërit: shiko atje, kur erdhëm ne kishte vetëm fusha të gjelbra.

Ende sot në Rocano ka shumë gjelbërim, por livadhet dhe pemët e qytezës janë të padukshme ose më mirë të tepërta. Nuk kanë ndonjë vlerë. Askush nuk i sheh. Qendrën e skenës e zënë blloqe të mëdha godinash, oborre me makina të parkuara, kthinat e derëtarëve tashmë të papërdorura, lulishte vetëm me ndonjë tugë bari, garazhe. Janë ndryshe vetëm disa zona të vogla, kryesisht të godinave private. Mbretëri mikroskopike të mirëqenies, mosvazhdimësi të banuara nga njerëz që nuk duken shpesh në qytet, shumë më pak të zhurmshëm dhe të sikletshëm se rocanezët e EBL-së.

Një lloj elite që jeton e tërhequr, e mbrojtur, që paguan qira më të lartë.

I vogël i përfytyroja këta njerëz të lumtur, të paarritshëm, të mrekullueshëm - jam i sigurt se për ta çdo gjë është më e lehtë. Do të doja të jetoja atje edhe unë: pse nuk linda në rrugën “Guido Rossa”, në “Valleamrimbosia”, në “Cassino Scaniaasio”? Pse nuk jam edhe unë si Loris, Dario, si Valentina?

Por zemra e vërtetë e Rocanos nuk qëndron në këto përjashtime, në këto oaze të privilegjuarish. Fryma e Rocanos është e gjitha e mbyllur në shtëpitë e familjeve që kënaqen me çfarë kanë dhe të atyre që nuk mjaftohen me aq dhe vendosin të shkelin ligjin. E zonjave që shkojnë në supermarkete të veshura me pizhame, të të rinjve të nxirë me solar dhe me flokë të ngrirë nga xheli, që ia shkelin gazit mbi motor, të adoleshenteve me veshje pas trupit, me makijazh të përsosur që në orën shtatë të mëngjesit dhe me këngët turbofolk me volum të lartë në kufje, të britmave që mbushin oborret dhe ngjiten lart, deri në majë të pallateve që mua më japin ankth, por dallëndysheve me sa duket jo. Majë pallateve, nën çati, vijnë dhe ngrenë folenë.

Rocanoja u nevojitej. Dhe e përdorën.

Problemi i ngutshëm i emigracionit.

Lagje konvikt, qytezë e harruar.

Ndër vite, në Rocano kullojnë gjithë pakënaqësitë e mundshme.

Bëhet garë se kush është në gjendje më të keqe.

Fqinji të jep shembullin e keq.

Familje tepër të ngjashme me njëra-tjetrën, në Rocano, të cilat kanë krijuar një nënkulturë specifike, ngritur me kode të panjohura për të tjerët. Janë të qarta gjërat në vendin ku jam rritur: meshkujt kanë një model të caktuar - motor, futboll, pidh - femrat një model tjetër. Mund të zgjedhësh njërën nga modelet. Çdo mëdyshje, çdo përpjekje për t'i tejkaluar kufijtë dallohet dhe ndëshkohet në çast. Publikisht, në rrugë, kudo. Sepse kodi është i shtrirë ngado dhe i pranuar nga të gjithë, për t'u ndier më të sigurt.

Nevojiten bindje, nuk ka vend për ngurrime.

Të gjithë rocanezët që kanë pasur fat - Michele Alboreto, Alberto Brandi, Arturo Di Napoli, Riccardo Morandotti, Antonio Sabato, Mauro Suma - janë meshkuj, sportistë ose gazetarë sporti. Përjashtimi i vetëm: Biagio Antonacci, mik fëmijërie i prindërve të mi. Ka shkuar në dasmën e tyre, madje edhe në spital kur linda unë. Është edhe në ndonjë fotografi të albumit të dasmës, libri i madh i veshur me pëlhurë dhe lëkurë ngjyrë kafe, që mamaja ka mbajtur me vite të varrosur në dollap, nën grumbuj rrobash dhe çarçafësh. Tani është shqyer, fletët nuk rrinë më bashkë, një e grisur e madhe pret në mes kartonin e mbuluar me lëkurë artificiale dhe stofi: ia hodha turinjve, më tha një ditë, atëherë kur e përzura nga shtëpia.

Për të gjithë banorët, qendra e Rocanos është bulevardi "Lombardia": një rrugë shumë e zakonshme, por për ne është

qendra e gjithçkaje, atje ku gjenden bankat, floktoret dhe dyqanet. Sot e kanë mësyre kinezët dhe e kanë mbushur me restorante, sallone për manikyr, dyqane “Linja 1 Euro”, dhe nga arabët, me qebaptoret dhe kasapët e tyre. Përgjatë asaj rruge ditën kalojnë me nxitim amvisat dhe, me nge, pensionistët, ndërsa në mëngjes herët dhe pasdite pas orës katër mbushet me fëmijë me çanta shpine dhe me diçka për të ngrënë në dorë.

Fëmijë të shoqëruar nga nëna me *piercing* në fytyrë, me tatuazhe dhe me cigaren në dorë, që me sytë e ngulitur në celular çfarë nuk nxjerrin nga goja.

Boll se na çave bythën, mos më çaj trapin.

I shikon edhe në tramvaj: vajza tetëmbëdhjetë ose nëntëmbëdhjetë vjeçe, me nga dy fëmijë secila, mbi të cilët hakërrehen për çfarëdo vogëlsie, me pickime dhe shuplaka. E shkartin edukimin si stërvitëse cirku me fjalime ku fëmijët trajtohen si të rritur: u kërkojnë këshilla, mendime, mësimet jete. Flasin me ta për para, shpenzime të papritura, sesi të arrijnë fundin e muajit. Pastaj fillojnë përsëri tërheqjet e veshëve dhe fluturojnë shuplakat, të ndjekura nga fjalë të ëmbla, përkëdhelje të papërmbajtura dhe nevrotike. Në tramvaj, fëmijët dërgohen të patrollojnë që të japin sinjal nëse vjen kontrolluesi, përndryshe duhet të qëndrojnë detyrimisht ulur.

O debil, po lëvize më, ta tregoj unë qejfin.

Pas bulevardit “Lombardia” fillon Sheshi i Bashkisë, kushtuar kryebashkiakut të njohur Giovanni Foglia. Një hapësirë e zhveshur, rrethore, kornizuar nga ndërtesa të ulëta që duken si kasolle betoni. Këtu ndodhet gjendja civile, kadastra dhe qendra e votimit. Deri në njëfarë kohe këtu ishte edhe biblioteka, por e zhvendosën te Kashina Grande, te Rocanoja “i vjetër”, në mashkullorë, po kështu thuhet. Rocano është mashkull, mbaron me “o”.

Drapri dhe çekani, në Rocano kemi edhe komunistë.

Gjyshërit e mi e përdorin fjalën *komunist* si fyerje: atje shkojnë komunistët, ai është komunist, shkon me komunistët. Komunistët takohen në lokalet e portikëve të qendrës dhe flasin për politikë. Kur kalon aty pranë shikon fletët e zverdhura të gazetave në tabelat e njoftimeve, dëgjon komentet e ngjirura dhe nervoze të pensionistëve të dehur që ulërijnë dhe hakërrehen, duke mbrojtur gjëra që i vogël nuk i kuptoja dhe më dukeshin të neveritshme, po aq sa mustaqet e tyre të thara nga nikotina dhe të njomura nga vera. Gjithmonë në qejf, pleqtë prekin me bërryla njëri-tjetrin nëse kalojnë atypari mamaja ose gjyshja ime.

Ikim, nëna.

Shpejtojmë hapin.

Në Rocano ka komunistë, por edhe të tjerë. Në mes të viteve nëntëdhjetë, në Rocano mësyjnë përfaqësues të partisë “Forza Italia”. Vijnë zonjat kandidate në listat e këshillave bashkiake, edhe të qytezave fqinje, veshur me peliçe dhe taka të larta. Ndalojnë në Sheshin e Bashkisë ose te pazari i së shtunës ose i të martës, mes mamave dhe gjysheve që dalin nga supermarketet “Pam” ose “Gigante” me flokët e shprishur, të kapur bisht me llastiqe të zhvatura ose kapëse me ngjyra evidenciatorësh. Vijnë të paraqesin programet, të gjejnë ithtarë, lënë sende me simbolin e partisë, stilolapsa, kapela, blloqe shënimesh.

Zonjë, mund t’ju lë një fletushkë?

E keni vendosur për kë do të votoni?

Nuk kam kohë.

Nuk më intereson.

Dikush përfiton nga rasti: i thoni Berluskonit të vijë të na ndihmojë, se jemi në ditë të hallit.

Rocanoja sot është edhe qendra tregtare “Fiordaliso”, që në vite është zgjeruar jashtë mase. E kanë përshtatur me modelet e qendrave tregtare amerikane. Jo më një ndërtesë e vetme me supermarket dhe dyqane, por një sërë ndërtesash të ndryshme: restorante, kinema me disa salla, kapanonet e artikujve sportivë dhe “bëje vetë”. Ka ardhur edhe pak botë në Rocano: njëfarë qyteze më vete, një zonë ku mund të bësh pazar dhe të zbavitësh, që e bën Rocanon më pak të izoluar.

Rocanoja është dhe Humanitasi, spitali modern i ndërtuar në kufi me Milanon 3, qyteza e ndërtuar nga Berlusconi. Vijnë nga e gjithë Italia për t’u kuruar atje. Njerëz të zakonshëm, por edhe personazhe të famshme. Rocanezëve nuk u pëlqen. Thonë që te Humanitasi të lënë të vdesësh. Më mirë të shkosh të kurohesh diku tjetër.

Më mirë të shkosh në Milano.

Rocanoja është kisha “Sant’Angelo” dhe kështjella “Cassino Scanasio”, mbikalimet dhe unaza, sheshi i ri kushtuar Alboretos dhe fushat e futbollit të kishës, Qendra Shëndetësore në Rrugën e Lulevilleve, ku ndër vite më gërmuan me trapan dhëmbët pa përdorur kurrë mpirje - *Zonjë, mbajeni pak, një minutë dhe mbaruam.*

Për mua Rocanoja ka qenë gjithmonë tri rrugë: Rruga e Zymbylave, Rruga e Lulemineve dhe Rruga e Lulepatateve. Shtëpia e mamasë dhe shtëpitë e gjyshërve. Tri pika të shënuara, tri streha, tri strofka gjithmonë të sigurta: historia ime dhe e familjes sime, që duket si një yjësi, pak a shumë si një hartë e mbivendosur nga sipër.

Rocanoja më urren.

Rocanon e kam urreyer.

Pse linda atje? Unë që lexoj, shkruaj, vizatoj. Unë që jam nxënësi më i dashur për mësuesit.

Pse pikërisht unë?

Me disa analfabetë si ju, unë nuk kam asnjë lidhje.

E megjithatë në Rocano ke lindur dhe je rritur.

Mblidhe mendjen: je edhe ti një nga tanët.

Jetoj në Rocano, por dua ta fsheh. Nuk dua që njerëzit ta dinë si është me të vërtetë shtëpia ime. Nuk dua ta shohë njeri këtë pallat me suvanë e rënë dhe njerëzit e frikshëm që dalin në ballkon. Nuk dua ta dinë që banoj këtu.

Kur më shoqërojnë me makinë në shtëpi nga Milano, ndaloj larg pallatit tim. I them atij që nget makinën, shok, i dashur apo i njohur qoftë: ndalo këtu, faleminderit, më lër te pika e karburantit ose te rrethrotullimi. Je i sigurt? Nuk është problem, të shoqëroj deri te shtëpia. Jo, jo, janë të bllokuara rrugët se po bëjnë punime. Më lër këtu, faleminderit.

Po bëjnë punime: punimet vazhdojnë treqind e gjashtëdhjetë e pesë ditë në vit në lagjen time. Çdo vit, në çdo stinë. As natën, në errësirë, nuk i lë të afrohen. Sepse Rocanoja është si letërnjoftimi im, por me rrugë dhe pallate, shpërfaqja materiale e frikës që kam se do të më zbulojnë dhe të më gjykojnë si ndonjë qyqar, fëmijë qyqarësh, punëtorësh pa shkollë, njerëzish që në rastin më të mirë kanë mbaruar gjimnazin.

Mundohem ta fsheh sepse e di që sado të mundohem, Rocanoja do të më gjejë sërish e do të më kthejë sërish në shtëpi. Një vrimë e zezë gllabëruese, perëndia e pamëshirshme që ngërthen bijtë më të pabindur, që tërheq sërish pranë vetes ciflat më naive, ato që mundohen të largohen, të bëjnë diçka në jetë. Thirrja që do të më ulë sërish poshtë. Një humnerë xheloze dhe e pamasë që më damkosi trupin në mënyrë që përkatësia të ishte e dukshme për këdo.

Më kot fshihesh, nuk të bën punë.

Ku kujton se do të shkosh?

Je nga tanët.

Ende sot druaj se Rocanoja do të pretendojë mbizotërimin e vet, do të kërkojë të marrë atë që i takon. Se do të dalë papritur nga diku, nga dokumentet, nga tiparet e mia të theksuara, nga banaliteti i veshjeve të mia dhe do të më detyrojë të kthehem edhe njëherë në internim, mes rrugëve me emrat e luleve.

Siç m'u desh të bëja këtu, tani, duke shkruar.

Rocanon e kam të ngatërruar me emrin tim, nëse flas për veten duhet të flas edhe për të.

Ika prej tij, por përsëri është i gjithi këtu.

Kam pallatet e tij të rreshtuara në kraharor, këmbët e mia vazhdojnë të ecin mbi rrugët e tij. Janë garazhet e tij, kinkaleritë, parqet e heshtura dhe të mbetura si pezull. Britmat me theks napoletan dhe puljez, fjalët e ndyra, të qeshurat e papërmbajtura. Hija e kullës Telekom më arrin deri këtu, në qendrën e Milanos.

I vetmi kod postar që mbaj mend, nga të gjitha shtëpitë ku kam banuar ndër vite, është 20089.

Do të mbetem gjithmonë në Rrugën e Zymbylave, nr. 10, te stacioni i fundit i 15-s.

Me frikën se do të vij në meshkujt.

28 janar

28 janar.

Përgjigjet e analizave kanë dalë.

Shpresojmë të jetë vërtet mononukleozë, virusi Epstein-Barr, sëmundja e puthjes.

Ndihem gjithnjë e më i lodhur, temperatura nuk bie, nuk pushon.

Të dal, të rri jashtë, më duket gjithmonë e më e vështirë. Dhe tani jam i detyruar të dal për të shkuar në spital: duhet të eci, të qëndroj në këmbë, të pres të vijë autobusi. Largësitë janë kërcënim, njësia matëse e dobësisë sime. Mendohej të bëj vetëm rrugë të shkurtra, tejet të shkurtra. Çdo herë druaj se nuk do të mbërrij në vendin për ku jam nisur.

Mamaja më shkruan çdo ditë në mëngjes.

Ç'kemi? Ke akoma temperaturë?

Po, shkon nga 37 në 37.3. Në darkë, ndonjëherë më shkon deri në 37 e gjysmë.

Diçka ka ngecur: termostati im i brendshëm është stabilizuar në nivelin e gabuar. Tashmë është e qartë, nuk do të shërohem vetvetiu. Nuk ka më kuptim të pres: kjo situatë nuk ka më kthim prapa.

Po ku e di ti?

Mëngjesin e 28 janarit shkoj t'i tërheq vetëm përgjigjet e analizave. Pres gjatë te stacioni i autobusit - 94 u vonua shumë. Ulem, mbështetem, pres ulur te shkalla e një dyqani mobilieësh në rrugën "Venezia", duke shpresuar se do t'i mbaroj të gjitha

gjërat që kam për të bërë: të ngjitem, të zbres, të përsëris hapat, të mbaj peshën e trupit që duhet të lëvizë.

Shikoj njerëzit që presin me mua: vihet re që nuk jam mirë?

Diferencim, ju jeni mirë, unë jo. Unë jam i sëmurë.

Vjen autobusi, dergjem në ndenjësë, mbështet kokën në dritare. Është pis - ka një njollë të lyrtë, me shkëlqim - po punë e madhe. Disa stacione dhe pastaj do të zbres. Dobësia përzihet me ankthin: këmbët i ndiej shumë të rënda ndërsa kaloj rrugën dhe arrij te dera e poliklinikës. Herën e kaluar kisha Alesandron, më ndihmonte ai. Sot duhet t'ia dal vetë.

Nuk di të orientohej, nuk dua të eci as edhe një minutë më shumë nga ç'duhet. Hyj dhe humb duke shëtitur mes shtigjeve krahe pavijoneve të spitalit. Kërkoj ku dorëzohen përgjigjet e analizave. Shumë tabela, asnjëra nuk është ajo e duhura. Pyes një çift mjekësh, e kanë me nxitim. Duket që janë mësuar me pyetje të tilla.

Ndjek udhëzimet e tyre, përfundoj në njëfarë zyre në krahe të një shkallareje. Duket si kioskë. Jap faturën, tërheq zarfin.

Kërkoj diçka ku të mbështetem.

Tani, menjëherë, duhet të ulem.

Nuk ka karrige.

Gjej njëfarë katedre të braktisur, lëkundet, mezi qëndron në këmbë. Mbështetem, hap zarfin. Të rrahurat e zemrës shtypin frymëmarrjen: kam frikë se do të gjej diçka të keqe në gjak, të konvertuar në numra dhe sigla. E kanë dërguar në laborator, e kanë studiuar dhe unë më në fund mund ta di se çfarë kam. Mirë apo keq, sëmundje e lehtë apo e rëndë. Sot do të marr vesh çfarë kam, nëse ka ndonjë shkak të qartë, se ka një emër dhe, ndoshta, një kurë.

Hap zarfin, lexoj sa më shpejt që mundem. Kapërcej vogëlsirat, më interesojnë anomalitë, vlerat e çrregullta, shenjat që të thonë: ja, prandaj ndihesh kështu.

Kjo është në rregull, edhe kjo.

Asgjë e pazakontë: duket çdo gjë në normë.

Vlerat e mononukleozës, këto janë?

Nuk i kuptoj.

I lexoj disa herë dhe përpiqem t'i deshifroj me ndihmën e vlerave të referencës.

Antitrupa anti EBV VCA IgG

105.00 U/ml

Antitrupa anti EBV VCA IgM

32 U/ml

Nuk janë as pozitive, as negative. Janë në fashën e ndërmjetme, “zona gri” është shkruar.

I shkruaj doktorit tim në *WhatsApp*: m’i trego analizat, më kishte thënë.

E kërkoj, i shkruaj.

Përgjigjet.

Më dërgo një foto.

I fotografoj një nga një të gjitha fletët e analizave, shtroj me dorë vijën e palosjes në mes.

Dërgoj fotografitë, dy vija blu në sfondin e gjelbër.

I pa.

Hë, lëviz.

Po më merr në telefon.

Lexon me zë shifrat ndërkohë që unë eci drejt stacionit për t’u kthyer në shtëpi.

Nuk duket i sigurt: po hamendëson?

Mundohet të më japë një përgjigje që as ai vetë nuk e ka?

E gjetëm, më thotë, e gjetëm. Ke mononukleozë.

Ashtu?

Prandaj ke ethe dhe lodhje. Duhet të pushosh, të pish shumë lëngje, të bësh durim. Kështu kam duruar edhe unë. Nuk ka kurë, ikën vetë.

Mami dhe babi

Mami dhe babi.

Lakuriq.

Në korridor, midis banjës dhe dhomës së gjumit.

Ngatërruar njëri me tjetrin.

Luajnë?

Mami, babi, po luani?

Mami merr gërshtët metalike, ato të kuzhinës.

Të gjata, me shkëlqim, të ftohta, me majë. I shtrëngon fort në dorë, po aq fort sa i shtrëngon edhe babi grushtin, teksa mundohet t'ia marrë.

Më lësho.

Më lësho, të thashë.

Nga sforcimi, mamasë i duken dhëmbët, mishrat e dhëmbëve, i mbyll sytë kaq fort sa duket sikur do t'i shpërthejnë kokërdhokët. Tendinat e kyçeve i kanë kërcyer jashtë: mundohet të ikë, të shpëtojë nga babi që i shtrëngon dhe i bllokon duart. Maja e gërshtëreve të ulura poshtë, në drejtëm të gjoksit të babait tim.

Pak qime, të errëta, në mes.

Mish, lëkurë, metal.

Mami dhe babi janë lakuriq dhe zihen përpara meje: më shfaqen përpara teksa dal nga dhoma, ku deri pak çaste më parë po flija. Kam diçka në gojë, biberonin apo thjesht thithën plastike. Ç'po bëjnë? Njëherë, psikologu im, ndërsa më lëvizte

gishtat përpara syve gjatë një seance EMDR - desensibilizim dhe ripërpunim përmes lëvizjes së syve - më pyeti: e mban mend si reagues kur u afrove? Kur të panë, kur e vunë re që ishe atje, ndaluan? Të thanë gjë?

Jo.

Nuk mbaj mend asgjë.

Kujtimi im i parë mbaron këtu: nuk ka asgjë më parë, asgjë më pas. Kujtimi i parë i jetës sime janë mamaja dhe babai që përleshën lakuriq me një palë gërshërë në dorë.

Nuk është e vërtetë, nuk ka ndodhur.

Mamaja thotë që e kam shpikur unë.

Dallimi më i madh me traumat që jeta na shkakton të gjithëve herët a vonë, më ka thënë gjithmonë psikologu, - i treti në rend kronologjik, - qëndron tek ajo që ndodh menjëherë pas traumës. Nëse shpesh ngjarja është e pashmangshme, vetëm mënyra se si veprohet me atë që ka ndodhur mund t'ia kthejë kuptimin humanizmit tonë, mënyrës se si na trajtojnë dhe se si do të trajtojmë veten.

Por, kujtimi im ndalet atje, i kristalizuar në një skenë që nuk është thjesht një skenë.

Është fati i paracaktuar, një *trailer*.

Kjo është historia që paraprin timen, historia e prindërve të mi. Tina dhe Roberto, rritur edhe ata, ashtu si unë, në Rocano. Të rinj, tepër? - nëna dhe babai im. Kur linda unë, mamaja është tetëmbëdhjetë vjeçe, babai njëzet e një. Unë vij rastësisht, mund ta themi: gabimisht. Nuk u treguan të kujdesshëm, nuk ishte çasti i duhur. Janë thjesht dy të rinj të lagjeve me banesa sociale që pëlqehen dhe dalin bashkë.

Një ditë mamaja mbetet shtatzënë.

Duhet të të them diçka.

Ti, çfarë do të bësh?

Kur marrin vesh për shtatzëninë, familjet ndërhyjnë, hyjnë mes tyre. Ofrojnë ta ndihmojnë ata çiftin e të fejuarve, që papritur po bëhet diçka tjetër.

Ndodhi gjithçka shumë shpejt - janë dy fëmijë, s'kanë filluar as punë, si t'ia bëjnë? - situata duhet rregulluar nga lart.

Ju ndihmojmë ne, mos kini merak.

Abort? Nuk bëhet fjalë.

Kështu deshi Perëndia.

Diskutime, lot, gëzim - dëshpërim?

Tina dhe Roberto, historia e prindërve të mi është historia e një dashurie që shumë shpejt ia la vendin urrejtjes dhe hakmarrjes. Një histori dashurie në Rocano: vendi ku jetojnë prindërit e mi është njëfarë matrice që përsërit veten vazhdimisht. Inati dhe konflikti përhapen në përmasa më të vogla, kudo. Mikrofizika e dhimbjes ka konflikt të mbrujtur në çdo gjë. Edhe në pikat në dukje më të qeta, në Rocano dëshira për t'u hakërryer e për t'u kacafytur nuk kalon kurrë plotësisht. Nuk shterojnë ndonjëherë fuqitë për atë punë.

Prindërit e mi janë nga dy familje rocaneze, sigurisht, por shumë të ndryshme nga njëra-tjetra. Dy fise, dy klane që i falen idhujve të kundërt.

Im atë, Robi, Roberto, familje nëpunësish: gjyshja, Nuça, origjinë siciliane, gjyshi Pier, Pierluixhi, milanez.

Ndërsa nëna ime është rritur në një familje napoletanësh, të ardhur në Veri për të gjetur punë, në fillim të viteve gjashtëdhjetë. Gjyshe Lidia, amvisë, dhe gjyshi Biaxho, apo Sizino, siç e thërrisnin, punëtor. Një familje e zhurmshme, melodramatike. Fjalë të ndyra dhe tallje, drekë, darkë, televizor: të gjithë në punë me nxitim, sa më shpejt të mundeshin. Arsimi, vetëm pjesa me detyrim: gjyshërit vetëm shkollën fillore, fëmijët e tyre, mamaja

dhe dajat, deri në gjimnaz - madje edhe aq me shumë mund. Në çastet e shumta kur më vonë, pasi dashuria ishte shuar, babai zihej me mamanë, e quante, pikërisht për këtë arsye, katundare, injorante muti.

Këto dy sfera të huaja u prekën me lindjen time. Në fakt thjesht u cekën. U pleksën në një pikë të vetme - në atë pikë të botës që isha unë - dy botë që në të vërtetë nuk kanë çfarë t'i thonë njëra-tjetrës. E që në fakt flasin fare pak.

Më tej vetëm zemërimi, qortime, kërcënime.

1982: babai dhe mamaja njihen tre vjet përpara se ajo të mbetej shtatzënë. Janë në të njëjtin grup shoqëror, kalojnë kohën midis kopshteve të rrugës "Lombardia". Me miqtë e tyre, motorët dhe biçikletat, rrinë poshtë shtëpisë së babait, në Rrugën e Lulepatateve. Në grupin e tyre janë edhe disa kushërinj të mamasë, disa ish-të dashura të babait dhe Biagio Antonacci-it, me të cilin babai luan muzikë nëpër kantina.

Ka shumë drogë në ato vite, sidomos heroinë. Ata nuk ngatërrohen, por shohin shumë të tjerë që përfundojnë keq.

Drogaxhinjtë e Rocanos në vitet e tyre të arta.

Ishte histori dashurie mes fëmijësh ajo e prindërve të mi: do të kishte zgjatur pa mua? Kam shumë pak copëza nga çfarë ka paraprirë ardhjen time në botë. Pak fjalë të thëna gabimisht mes shumë bisedave të tjera.

Historinë e prindërve të mi e pllakosi *damnatio memoriae*, dënimi i harresës.

Nuk ka ekzistuar kurrë, nuk ka ndodhur.

Unë nuk di asgjë nga koha kur ishin bashkë. Në mendjen time kanë qenë të ndarë që prej zanafillës, mami - hapësirë, disi e madhe, - babi.

Nuk di gjë për puthjet, dashamirësinë, dashurinë mes tyre.

Nuk më kanë treguar asgjë: e imagjinoj vetë, ndonjëherë, në dritëhije, nga fjalët e mamasë dhe të gjyshes. Del në sipërfaqe,

ngrihet nga cekëtinat e gjërave të kaluara, si mbetje e diçkaje që nuk do të zhduket kurrë.

Yt atë e ka fajin, yt atë ka përgjegjësinë.

Rritem nën hijen e këtij gjykimi të njëanshëm, rritem me frikën se jam si ai.

Njeri i paqëndrueshëm, i pakuptueshëm, mut muti.

Por, e di si ishin mamaja dhe babai, secili më vete, në moshën e adoleshencës. I kam përfytyruar, marrë me mend, kam mësuar t'i përshquaj përmes kujtimeve të të tjerëve.

Njëzet vjeç, babai nuk ka dëshirë as të studiojë, as të punojë. Gjithmonë i trazuar, tekanjor, me mendjen te vajzat: ka pasion makinat dhe motorët, i bie baterisë. Është admirues i Renato Zero-s: flokët i mban të gjatë që t'i mbulojnë veshët e mëdhenj, mbahet dhe vishet që t'i ngjajë sa më shumë këngëtarit roman. Babai im, që ndër vite do të tallet me homoseksualët dhe do të mbajë një fotografi të Musolinit në portofol, në rini ka qenë adhurues i flaktë i Zero-s.

Roberto është i gojës, ua merr mendjen të gjithëve. Dhe përfiton, bën çfarë të dojë: fillon gjimnazin, por i del nga qejfi shpejt dhe e lë që pas vitit të parë. Mundohen ta dërgojnë në oficinën e një mekaniku që të mësojë një zanat, por mërzhitet edhe atje - Yt atë shkonte të punonte vetëm kur donte të blinte ndonjë gjë, e blinte dhe pastaj e linte punën. Kështu ka qenë gjithmonë yt atë, nuk do të ndryshojë ndonjëherë, - më thoshte vazhdimisht mamaja. - Atij i ke ngjarë - thotë me bindje - si yt atë je edhe ti.

Pikërisht në vitet e lidhjes me mamanë time shkon ushtar dhe vë mend në kokë, ndoshta më shumë nga halli se nga dëshira. Pas shumë punëve të ndërprera, e lë atë zakon, dorëzohet. I duhet të mbajë shtëpinë, po bëhet kryefamiljar. Duhet të kujdeset për gruan dhe fëmijën: unë dhe mamaja, dashuritë e tij, mbretëria e tij. Unë dhe ajo, arsyet e vetme që e nxitin të vërë mend në kokë.

Bëhet polic.

Çfarë pune bën babi?

Babai im - ndaloj, ta zgjat kënaqësinë - është polic.

Ndryshe puna me mamanë.

Një metër e pesëdhjetë pa taka, sy të gjelbër dhe flokë gështenjë, ndonëse me kalimin e kohës i bën në fillim të verdhë e më pas të kuq. Vesh funde të gjata, këmisha me lule, flokët deri në supe, këpucë të sheshta ose çizme si të indianëve të Amerikës. E quajnë Konçeta, si gjyshja e saj, si nëna e gjyshit tim, por e thërresin Tina. Më e bukura nga shoqet, më e pëlqyera nga djemtë: janë disa që dëshirojnë të lidhen me të, por nuk bëhet fjalë, ka zgjedhur babanë tim.

E ëma, gjyshja ime, do të donte që ajo të fejohej me Jurin, djalin e fqinjës.

Pse, moj Tina, nuk të pëlqen?

Boll, mami, jam e lidhur me Robertson.

E bukur Tina, Tina bukuroshja, por edhe e ashpër, serioze, kokëfortë, e kundërta e atyre çupëlinave të tjera.

Nuk i zë besë askujt, ka besim vetëm te personat më të gabuar.

Mamaja e lë shpejt shkollën dhe deri kur njihet me babanë tim jeton e kyçur në shtëpi. Kështu do i ati, gjyshi im. Nuk i lejohej të lëvizë: gjyshi e ruan sikur të jetë dhjetë vjeçe. Nuk e lejon të dalë, paratë i ka të numëruara.

Femrat rrinë në shtëpi, ndihmo tët ëmë me punët, kur të martohesh bëj ç'të duash.

Kur mami thotë se i pëlqen diçka për të ngrënë, ai fillon t'ia blejë vazhdimisht. Të kemi rezerva, thotë. Sidomos kur i gjen me ofertë. *Babi, më habet çokokrem*: dollapi mbushet javë pas jave.

E kërkove, tani mbaroje.

Nuk më hahet më.

Ta hedhim atëherë, si thua?

Herë pas here mamaja punon si dado në një familje të njohurish, si dhe në një kioskë verore. Dalin zëra se po hapen disa zyra të reja, është fillimi i viteve tetëdhjetë, kanë filluar të përdoren kompjuterët e parë. Vjen mundësia e një pune. Ia propozojnë, mund të fillojë një punë të mirëfilltë, të bëjë diçka në jetë.

Por jo, nuk bëhet, gjyshi nuk do.

Shumë larg, si do të kthehesh në darkë?

Rri në shtëpi, çfarë të mungon?

Tina dhe Roberto, nëna dhe babai im: t'i shqiptoj, t'i shkruaj këto fjalë bashkë futem në krizë. Kthen brenda meje thyerjen parake, telashin brenda telashit. Simulon një ribashkim të kotë, të pavërtetë. Sepse për të qenë të singertë, nuk ka asgjë për të bërë bashkë sërish: nuk ka pasur ndonjëherë familje. Më e shumta ka pasur një përpjekje, një eksperiment.

Nëna dhe babai im më ngjizin në fund të verës, duke parë filmin “Skamje dhe varfëri” të Toto-së. Martohen me nxitim për t'i gjetur zgjidhje shtatzënisë që u doli papritur, por përpjekja e menduar bashkë me prindërit për t'u bërë papritur familje nuk ecën. Përfundon mjaft keq.

Unë lind më 13 qershor 1985. Viti i dëborës së madhe, veçse lind në pranverë, në orën dhjetë e dhjetë të një të enjteje në mëngjes. Binjak me shenjë lindjeje me ashendent Luanin, ajër që fryn mbi zjarr. Dhjetë e dhjetë, ashtu si vendosen akrepat e orëve në vitrina.

Lind dhe jam disi i madh: tri kile e pesëdhjetë - përsërit vazhdimisht mamaja. Unë jam trofeu i saj. Një fëmijë i madh, lindje me dhimbje të jashtëzakonshme.

Mamaja saktëson, mohon: po, e vërtetë, nuk e kishim në plan, por unë doja të të mbaja.

Pastaj punët shkuan ashtu si shkuan, por ti nuk ishe gabim.

Linda më 13 qershor, por jo në Rocano. U rrita në Rocano, por linda në Milano, në spitalin “Niguarda”, edhe pse i vogël ky fakt më bënte krenar, ashtu si bukuria e mamasë sime apo miqësia e babait me Biagio Antonacci-n: të paktën në lindje, ta dinë të gjithë, nuk isha në territorin e Rocanos.

Një rrugë me shpejtësi skëterre me makinë. Jam shtatëmuajsh: dua të dal shumë herët. Pastaj ndërroj mendje. Arrij ta mbaj veten dhe atëherë nuk dua t’ia di më: meqë nuk donit më parë, tani nuk dua unë të lind. Duhet të vendos vetë, edhe pse mund t’i bëj dëm vetes.

Lind me dy javë vonesë, mamaja shkon në spitalin “Niguarda” për një kontroll dhe nuk kthehet më në shtëpi. E mbajtën atje deri në fund. Unë lind me dy shenja në lëkurë: njëra në formë shalqiri, e gjerë dhe e kuqe, në shputën e këmbës së majtë dhe me një njollë të vogël ngjyrë kafeje me qumësht, në bark, pranë kërthizës. I sapolindur i ngjaj më shumë gjyshes, mamasë së babait, quhet Agata, por e thërrisnin Nuça. I ngjaj sidomos nga hunda e madhe, si e zezakëve, si patate. E gjithë ajo degë e familjes sime ka tipare ekzotike: stërgjyshja ime nga Katania e kishte lëkurën shumë të errët, saqë kam imagjinuar gjithmonë ndonjë prejardhje arape. Ia tha infermierja mamasë, kur më la në krahët e saj pas lindjes.

Shikoje, s’i ka lënë gjë sat vjehrrë.

Barra ia prish trupin mamasë: shtatzënia dhe lindja i lënë shenja që nuk do të zhduken më. Kilet e shtuara ia mbulojnë trupin me strija - kur isha i vogël më dukeshin si njollat e tigrave - ndërsa gjatë lindjes infermieret dhe mamia e lëndojnë për të më nxjerrë.

I hipin mbi bark, pa dashur i thyejnë hundën me bërryl.

Gjeta një fotografi që na ka bërë babai sapo kemi dalë nga spitali: mamaja me buzët varur, në diell, me një balluke të gjatë që

gati i mbulon sytë. Ka veshur një fustan të gjerë, të deformuar, të blerë gjatë shtatzënisë. Jam edhe unë, por nuk dukem: unë, shkak, arsyeja pse ndodhën të gjitha këto, rri i mbrojtur, i fshehur në një karrocë blu të errët nën diellin e qershorit.

Më quajtën Jonathan, sepse kështu donte mamaja.

Si pulëbardha, ndonëse ajo nuk e di.

Në ato vite shfaqej në televizion programi i Ambrogio Fogar-it, *“Jonathan - Dimension aventure”*. Kam emrin e një emisioni për natyrën dhe sportet ekstreme, i drejtuar nga dikush që nuk përfundoi mirë.

Emrin tim e zgjodhi mamaja meqë isha djalë. Babai donte vajzë: po të kisha lindur femër do të ma kishte vënë ai emrin. Do të më kishte quajtur Desirée - babai pëlqen gratë e buta, të bindura. Por linda mashkull, kështu që më quajtën Jonathan, ashtu si donte Tina. Edhe pse të afërmit do të pëlqenin një emër më tradicional, një emër italian, të qartë, të lehtë për t’u shkruar dhe shqiptuar.

Lindi më 13 qershor: quaje Antonio, si shenjt i Padovës.

Mamaja nuk heq dorë: është im bir, vendos unë. Gjithë jetën i ka ardhur turp nga emri i saj - Konçeta, si plakat e Jugut - nuk do të më ndodhë e njëjta gjë edhe mua.

Është djali im, do ta quaj Jonathan.

Ashtu si shkruhet, me “th”, siç e shqiptojnë anglezët dhe amerikanët, me gjuhën mes dhëmbëve.

Në familje askush nuk e shqipton si duhet.

Më thërrasin si t’u vijë për mbarë.

Sxhonata,

Xhonata.

Në italisht do të ishte Xhovani?

Emri im vazhdon të shkaktojë probleme edhe pas lindjes: prifti i kishës Sant'Angelo nuk pranon të më pagëzojë. Nuk është në kalendar, thotë, nuk ka shenjt me atë emër. Mamaja nuk heq dorë: por detyrohet të ndërrojë kishë.

Jonathan Bazzi: mbiemri i babait, emri që zgjodhi mamaja, bashkë. Bashkimi, shartimi. Diçka që nuk shkoi mbarë.

Më quajnë Jonathan, por diku ekziston dhe Desirée-ja, vajza që dëshironte babai, ajo që do të kishte pasur pak më shumë vëmendje. Diku ekziston Antonio, djali i Rocanos, nipi i mbarë. Ai që do të fitonte respektin e të gjithëve, që do të shpëtonte gratë e jetës së tij nga ulërimat dhe duart e liga. Ai që do të mbrohej, që do të rritej e bëhej burrë me të vërtetë.

Avatarët tanë, të shtuar a të munguar, na përcaktojnë. Emrat e munguar të një fëmije, historia e nisur përpara ardhjes në jetë. Pritshmëritë, ëndrrat e të tjerëve, misioni i parë që na besuan.

Emri im, tetë germa.

Unë të shoh kështu, mos më tradhto.

Pas disa muajsh të strehuar në shtëpinë e gjyshërve, unë dhe prindërit shkojmë të jetojmë në një apartament të vogël, dy dhoma e kuzhinë, në Rrugën e Zymbylave, pranë kullës Telekom dhe stacionit të fundit të autobusit 15. Mes prindërve problemet fillojnë menjëherë. Mamaja kalon nga njëri burg në tjetrin. Edhe babai im nuk e lejon të bëjë asnjë gjë.

Ç'të duhet puna, rri në shtëpi, merru me djalin.

Mos dil, ku shkon me atë bluzë aq të hapur.

Prit të të shoh, çfarë ke veshur? Jo, shumë i shkurtër fundi, shko ndërrohu.

Asnjë s'mund të më prekë, askush nuk duhet të na afrohet. Maniak, obsesiv, i sëmurë pas rregullit dhe pastërtisë, babai ankohet për gjithçka që mamaja nuk bën apo nuk di të bëjë.

Fillon të sillet keq, e shan, e poshtëron: dhi, debile, kare, napolitane.

Kthehej në shtëpi dhe gjente enët e palara, ma përsëriste me dhjetëra herë ndër vite gjyshja ime, mamaja e babait, si për të justifikuar tradhtitë dhe ikjet nga shtëpia të të birit. *Torollake ka qenë jot ëmë, për asnjë gjë s'ishte e zonja* - e imagjinoj si ato gratë prehistorike, shpellare, me flokët e palarë, me morra, veshur me lecka.

Akuzat fillojnë menjëherë, nga të dy krahët.

Përfshijnë edhe familjet, fillojnë hakmarrjet, luftërat.

Nga koha e paktë që kaluam bashkë mua më kanë mbetur vetëm pak skena të shkëputura në mend. Asnjë kujtim i bukur. Më janë ngulitur vetëm të këqijat? Ka pasur gjë tjetër?

Një periudhë kohe nuk jemi vetëm në apartamentin që na caktoi bashkia: jeton me ne edhe Ambroxho, një qen bobtail trupmadh, që më sjell rreth e rrotull nëpër shtëpi duke më ngritur nga pelenat - edhe atij ia kanë vënë emrin prej Fogar-it? Nuk e mbaj mend: ma tregojnë kur rritem. Nuk e mbaj mend sepse Ambroxho ikën shumë shpejt, e heqin nga shtëpia. Është i pari nga shumë kafshë shtëpiake që hyjnë në jetën time për t'u zhdukur pa lënë gjurmë. Zakonisht i merr mamaja dhe pastaj i heq qafe. Pas Ambroxhos e pati radhën macja Borëbardha, pastaj qenushja Tabata, më pas *yorkshire*-i Çarli dhe një *rottweiler* Atos - përçapja e vetme e babait me kafshët, e dështuar gjithsesi në fare pak muaj - e pastaj macja persiane Lulu dhe konia *sbar pei Pongo*. Kafshë që zhdukeshin, humbitnin, bëheshin erë: mamaja i merr, por pastaj nuk di të kujdeset.

I pëlqejnë vetëm konet apo kotelet?

Di të jetë besnike vetëm me ata që sillen keq?

Kam pak kujtime nga dy vitet e jetuara bashkë me prindërit, por nuk do të ishin gjithsesi kujtime të lumtura.

Babai shkon edhe me të tjera, e tradhton mamanë. E ka tradhtuar gjithmonë, por bëhet edhe më keq me kalimin e kohës. Ajo reziston ca kohë - *Bëje për djalin* - pastaj nuk mundet më. Nervat nuk i mbajnë, bie në depresion. Mendojnë se ka epilepsi, ka kriza nervore të vazhdueshme. I bie të fikët, dridhet, i dalin jargë nga goja: dorëzohet përballë një dashurie të shndërruar në farsë, mashtrim, rrënim.

Tina ka luajtur mendsh, Tina është e sëmurë.

Mamaja bën skena të tepruara, bërtet.

Mos e lini vetëm me djalin.

Kujdes, jepini ilaçet për depresionin, ilaçet për epilepsinë.

Mos e lini të dalë, mos e lini vetëm.

Mbylleni në shtëpi.

Kam mësuar prej saj, ndoshta që atëherë, që t'ia lë detyrë trupit që ta shfaqë atë që nuk di të përballojë në mënyrë racionale me fjalë. Trupi që nis të flasë vetë, që, duke vërshuar, thotë çfarë nuk mund të thuhet. Që tregon çfarë është lënë mënjanë, çfarë është heshtur. Që rebelohet ndaj regjimit të përjetshëm të etërve, të bashkëshortëve, të gjyshërve. Është tradita e histerikeve, etiketa me të cilën pushteti mashkullor ka damkosur ndjenjat e atyre që dalin nga rreshti.

Kam si arketip marrëdhënieje një çift armiqsh: mami dhe babi kanë ikur, nuk duheshin mjaftueshëm, por më parë se të shteronte gjithçka, ajo pak dashuri mes tyre u riprodhura.

Më krijoi mua.

Unë jam e papritura e nxituar në një histori që nuk zgjati thujtse fare.

Çfarë kishte mes tyre nuk u zhduk.

Thjesht u zhvendos.

Nuk e besoj

Nuk e besoj.

Kam frikë se nuk është e vërtetë.

Dhe nëse nuk është e vërtetë, thjesht po humbasim kohë. Sëmundja do të bëjë të sajën: po e lëmë të bëjë çfarë të dojë, trupin tim e ka në dispozicion. Mua më ka në dorë.

Këtë do të bëjë.

Tridhjetë vjeç, mjeku i tij mendonte se kishte mononukleozë, vdes nga leucemia.

Milano: familja e të riut kërkon të sqarohen përgjegjësitë e një vdekjeje që mund të ishte shmangur.

Kthehem në shtëpi, vazhdoj kërkimin në rrjet, lexoj faqe interneti, forume, kërkoj mes rezultateve të analizave dhe përshkrimet të simptomave. I hap faqet njëra pas tjetrës.

Jo, nuk e kam.

Nuk kam mononukleozë.

Mjeku e ka gabim. Në të vërtetë nuk di çfarë të thotë.

I shkoj edhe një herë te studioja, i jap rezultatet e analizave, ato që i kisha dërguar në *WhatsApp*.

Në fakt rezultatet janë të dyshimta, thotë. Ndoshta po të kalon ose e ke pasur më parë. Ndoshta kur ke qenë i vogël.

Si po më kalon? Unë jam sëmurë tani, po bëhem gjithmonë e më keq.

Vazhdojmë me vitaminat dhe suplementet, thotë. Ah, shiko, sot më sollën disa kuti falas me hape me barna. Është një rrënjë e fuqishme kinezë, bombë fare. Ta jap një kuti, po deshe.

Më thuaj nëse i do.

Kthehem në shtëpi, shtrihem. Mbledh këmbët, kruspullosem. Pyes dikë tjetër.

I dërgoj një *e-mail* nga celulari Lorencos, një djalë që kam njohur vite më parë në një kurs joge. Është mjek, gjinekolog, jep mësim edhe ai. Më vjen pak turp - nuk kemi shumë afri - por është mirë të marr sa më shumë mendime që të jetë e mundur.

Më përgjigjet menjëherë: simptomat janë si të mononukleozës.

E pyes specifikisht për rezultatet e analizave të mia, por nuk përgjigjet më. Duhet të pyes një kolege, më thotë.

Heshtje. Asgjë më tej.

Të ketë harruar.

Nuk ka kuptim t'i shkruaj më.

Atëherë ndryshoj konsulent, i shkruaj Euxhenias: punonte në televizion, pastaj e la dhe u bë instruktore për *Iyengar*, joga e stërvitjes. Më thotë të pi lëng papaje të fermentuar: kushton pak, por forcon sistemin imunitar. Meqë nuk ka kurë specifike për mononukleozën, ndërkohë mund të përdor këto trajtimet e tjera.

I vazhdoj kurset. Dhe kur jam në punë hiqem sikur jam mirë.

Nuk u tregoj përgjegjësve të vendeve ku punoj se nuk jam mirë: mononukleozë është ngjitëse, mund të më pushojnë. Vazhdoj me kurset edhe pse nuk do të doja: nuk mund t'i lë sepse më duhen paratë. Unë vetë nuk i bëj pozicionet, mundohem t'i udhëheq me zë. Kur ndihem shumë i lodhur mbështetem në mur ose ulem në tokë.

Përpiqem të mos bie në sy.

Dua të mos dal më nga shtëpia, por nuk kam ç'të bëj. Çdo herë mendja shkon tek ajo që vjen më pas, mendoj ditën kur do të marrë fund gjithçka. Kaloj nga divani në shtrat. Fshihem nën batanije me macet, fle dhe rregullisht më fillojnë djersët.

Zgjothem, ngrihem, ndërrohem dhe bie përsëri në shtrat.

Ky është ritmi i ri i ditëve të mia.

Një vazhdimësi veprimesh pa të ardhme.

Asnjë projekt, asnjë dëshirë.

Kur papritur një ndryshim: nuk kam më vetëm temperaturë.

Acarim në qiellzë, rrufë, mukus, dhimbje fyti.

Një javë, dy javë: të ketë qenë grip i pashpërthyer?

Tani do të shfryjë dhe do të kalojë, si çdo grip që kam kaluar.

Ishte një fazë, një çast dobësie, ndodh.

Mamaja më merr në telefon: si ndihesh?

Si gjithmonë, por me siguri nuk do të dal për vrap.

Jo, natyrisht. Pak nga pak.

Më ulet tonaliteti i zërit, kordat zanore të bllokuara, rëndohen edhe rrugët e frymëmarrjes. Tri herë në ditë thith avullin e tenxheres më të madhe që kam në shtëpi, mbushur me ujë të nxehtë. Në ujë hedh dhjetë pika *Tea Tree Oil*, vaji i nxjerrë nga *maleleuca*, një bimë australiane që përdorin aborigjenët. E kam lexuar në internet: bën shumë mirë për inflamacionin.

Një, dy, tri ditë.

Nuk më bën asgjë.

Filloj ta marr vajin edhe në rrugë orale: vetëm disa pika, më këshillojnë ata që dinë nga këto punë. Zgjidhje drastike, thonë, nuk duhet abuzuar. Është shumë i fortë, ka aromë deodorantesh për dollapë. Shija të mbetet në gojë me orë.

Dy ditë, tri, katër: i njëjti rezultat, nuk më shëron.

Në mos qoftë mononukleozë, çfarë të jetë?

U bënë javë që kam temperaturë, si ka mundësi?

Nuk kam si të mos filloj të kërkoj në *Google*. Po sikur të jetë tumor? Leucemi? Vazhdoj kërkimet në rrjet, e stërmundoj veten me informacionet e gjetura *online*. Mariusi më thotë të mos vazhdoj më, se nuk ka vlerë. Po ku tjetër ta mbaj mendjen?

Lexoj vazhdimisht të njëjtat gjëra, pa fund. Mësoj simptomat, zhvillimin dhe kurat për një numër të pafund sëmundjesh, zhytem ditë pas dite në një garë të brendshme mes hipotezave dhe skenarëve më të errët. Mes mundësive zgjedh gjithmonë atë më të bujshmen, atë pa shërim: shkoj më tej, duhet të mbaj në fre panikun. Edhe pse e kam më të lehtë t'i shkoj pas fillit: duke hamendësuar gjithë të ligat e mundshme.

Boll, e ndava mendjen: tumor është.

Do të vijë, madje po vjen koha e kimioterapisë.

Do të më thonë datën e shtrimit. Do të përshëndes të dashurin, do të përshëndetem me të dhe me macet. Do t'i puth - për herë të fundit? - dhe do të shkoj të ma mbushin trupin me tuba dhe kimikate e do të ndihem edhe më keq se tani. Do të jem larg, në shtrat, do të kem nevojë për ndihmë për të bërë çdo gjë.

Do të vish të më takosh? Do të më duash edhe kur të jem duke ikur?

I shtruar në spital, larg nga këtu, nga shtëpia jonë. Unë, që nuk largohem kurrë, që nuk mund t'ju lë vetëm as dy ditë rresht, do të përfundoj në ndonjë spital të padëgjuar kurrë. Do të më bien të gjitha: vetullat, qimet, flokët.

Si duket një fytyrë kur s'i ka mbetur më asgjë?

Fle gjithmonë e më shumë - fle për të mos menduar, për të pasur më pak frikë. Nuk jam më në gjendje të lexoj, as të shkruaj, prandaj fle, fikem, qetësohem me gjumin. Filloj t'i anuloj kurset në palestër, u them të më zëvendësojnë. Më marrin në telefon, më kërkojnë. Shpeshherë nuk përgjigjem.

Pse nuk erdhe? Të prisnim.

Nuk kam më interes për asgjë, nuk kam më fuqi të kontrolloj, të kujtohem, të tregohem i përgjegjshëm - shpenzime, afate, fatura - të mbledh paratë për shpenzimet dhe qiranë.

Të shkojë si të shkojë.

Unë e mora vesh se çfarë më pret.

I shkruaj mjekut tim: po mendoj të shkoj tek Urgjencia, nuk po duroj dot më.

Sa e ke pasur temperaturën?

Mbrëmë dhe sot në mëngjes ishte në rregull, tani më shkoj 37.3.

Nëse do të ndihesh më i qetë, shko.

Shkova vërtet, por nuk zgjidha gjë: kjo imja nuk është urgjencë, thonë.

Duhet të vazhdoj me mjekun tim.

Mund të më japin vetëm “kodin e bardhë”, jo kodin e urgjencave.

Perspektiva e pritjes me orë në karrige më dërrmon. Shtrat, divan, unë kam nevojë të shtrihem.

Kthehem në shtëpi.

Një pasdite, dy, pesë.

E humb konceptin e kohës.

Kërkoj diçka për të parë përpara se të bie në gjumë.

Në *YouTube* hap njëra pas tjetrës videot e publikuara nga Maurizia Paradiso kur ishte e shtruar në spitalin e Monzës dhe bënte kimion për leuceminë. Fjalë të pista, ulërime, pa censurë. Ajo bën shaka, unë përgatitem për atë që më pret. E shikoj të qeshë, çirret, shan: se mos është fundi i botës. Ka jetë edhe atje. U ka ndodhur edhe të tjerëve: më tregoni si bëhet kjo punë. Gjej videon e disa vajzave që zbuluan se ishin me kancer dhe vendosën të dokumentojnë ditë pas dite çfarë përjetonin. Gra njëzet apo tridhjetë vjeçe, pa flokë, të fryra, me lëkurë të hirtë dhe rrathë të zinj nën sy.

Do të më vijë radha edhe mua, patjetër, por nuk duhet të vdes tani për tani, jo kaq shpejt: duhet të filloj kimion, ndoshta të operohem. T’i marrim gjërat me radhë.

Rezistoj edhe pak, shkoj te mjeku.

Shiko, unë vazhdoj të jem sëmurë.

Shohim edhe një herë analizat.

Prit pak, nuk ta kanë bërë hemogramin, gjakun komplet, është analiza më e rëndësishme, e para gjë që shihet. Rruazat e kuqe, rruazat e bardha, pllakëzat e gjakut: atje dallohet infeksioni, madje edhe tumoret.

Nuk ma kanë bërë?

Ndoshta jam ngatërruar unë. Mendova se ta kisha shënuar, por mbase nuk e kam pasur mendjen. Më fal, ndonjëherë ia këpus kot edhe unë. Bëjmë hemogramin dhe meqë jemi kontrollojmë edhe diçka tjetër. Sa kohë ke pa bërë testin e HIV-it.

Kam pak.

Gënjej.

Nuk e kam bërë kurrë.

Një vjeç kisha një familje

Një vjeç kisha një familje.

Tre vjeç jo.

Pas zënkave, ulërimave dhe krizave të panikut prindërit e mi ndahen.

Ndarjen e kërkon mamaja.

Fajin e ka Barbi.

Barbi është tetëmbëdhjetë vjeçe dhe studion për drejtësi në Universitetin Katolik. Fakulteti i saj ndodhet pranë kazermës së babait tim, në lagjen “Sant’Ambrogio”. Nuk e di mirë si u njohën - një lokal, një kafe, *Ah studion këtu, mund të të drejtohem me ty?* - por di që lidhja e tyre shkaktoi ndarjen përfundimtare mes prindërve të mi.

E bukur, jashtë mase e bukur: për Barbarën, domethënë Barbin, dëgjoja vetëm fjalë të hatashme. Bionde, me sy të kaltër, më thoshin: e ke parasysh kukullën Barbi? Ja, ashtu. Yll e bukur dhe e pasur: jeton me një avokat. Mos vallë mitizimi i bukurisë së Barbarës kishte synim të tregonte se babai kishte bërë mirë që kishte tradhtuar mamanë?

Gabim ka bërë, patjetër, po shiko sa e bukur, si kukull.

Edhe mamaja ime e bukur është, por nuk ka flokë të verdhë dhe sy të kaltër.

Edhe mamaja ime e bukur është, por nuk është e pasur.

Ndërroi lodër, yt atë, siç e ka zakon. Ka gjetur lodër të re.

Barbara është e para e listës së gjatë të shoqeve të babit.

Do të vij me një shoqe.

Ç'kemi, zemër, kjo është shoqja ime.

Erdhi të të merrte babi?

Po, bashkë me një shoqen e vet.

Paola, Sara, Zhizela, Kozeta, ajo që shkuam te kopshti zoologjik, ajo e pishinës: çdo herë një vajzë tjetër, i takoj një herë dhe kaq. Ndonjëra më pëlqen, ndonjë tjetër më pak, por nuk ka rëndësi. Sepse nuk kam kohë të mësohem me asnjërën. Shfaqen e zhduken pa ndonjë shpjegim. Disa janë të sjellshme dhe flasin më shumë, disa ndihen në siklet: jam djali i policit me të cilin po shiheshin - *Po, mbrëmë u takuam prapë, madje kishte edhe djalin me vete.*

Barbarën e takoj disa herë. Menjëherë pas ndarjes, kur shkoj te babai, është edhe ajo. Ai më thotë të mos i tregoj mamit. Një natë - dimër, përpara Krishtlindjes - shkojmë ta merrnin në shtëpi. Ndalojmë pranë pallatit të saj dhe ndërkohë që e presim babai më fut në bagazh. Mbyllur brenda, në errësirë. Për t'i bërë një surprizë, më thotë.

Ti mos fol, të nxjerr unë.

Sa kohë duhet të rri brenda, babi?

Babi, çfarë do të bëni kur të jem i fshehur në errësirë?

Mos i thuaj gjë mamit për Barbarën, mos i thuaj që dolëm të tre bashkë.

Mirë, babi - them duke ulur sytë.

Kur kthehem në shtëpi ia tregoj të gjitha.

Ah, e kishte marrë edhe atë?

Po, mami, ishte edhe ajo.

Mamasë ia tregoj të gjitha, e di mirë që e humb logjikën për hiçmosgjë.

Babi më çoi atje ku ti nuk do që të më çojë.

Më dha pislëqe për të ngrënë.

Më mori vetëm për dy orë.

Nuk më telefanoi.

Nuk erdhi.

Nxehe mami, ai e ka fajin. Babi nuk di, nuk bën si i thua ti, nuk më do, gënjen, shpenzon për vete, ndërsa për ne thotë që nuk ka.

Filloi atëherë, kur isha tre apo katër vjeç, tensioni i përhershëm mes prindërve, që shtohet, por thujse asnjëherë nuk shpërthen, fusha magnetike ku u rrita, i tërhequr herë nga njëri pol, herë nga tjetri. Mami, babi, unë në mes. I ndërsej kundër njëri-tjetrit si dy qen të tërbuar, ushqej mëritë, kërkoj vëmendjen e tyre.

Filloj edhe të gënjej, jam gati të bëja gjithçka, vetëm që të më vënë re.

Babai dhe Barbi zhvendosen të jetojnë në një rezidencë në Pieve Emanuele, pranë Operës, njëfarë hoteli për qëndrime të gjata, ku marrin një dhomë gjumi, kuzhinë dhe thujse asgjë tjetër. Por lidhja e tyre nuk ecën. Ai ia nxin jetën: është tepër xheloz, kur del e mbyll në dhomë që të mos ketë mundësi të lëvizë. E ngujuar, Barbi. Edhe ajo tetëmbëdhjetë vjeçe, si mamaja kur mbeti shtatzënë, edhe ajo e njohu anën tjetër të babait tim pas mahnitjes së fillimit. Barbara ia mbath, kthehet në Milano te prindërit.

Pas ndarjes, mamaja qëndron te shtëpia në Rrugën e Zymbylave, ndërsa babai ikën.

Nuk dua asgjë, vetëm pagesën mujore për djalin.

Nuk dua asgjë, vetëm ik.

Në fillim mamaja, në të vërtetë, ia kthen pagesën mujore: takohen pranë postës së Rocanos, mamaja tërheq paratë e pagesës dhe ia kthen. Ligjërisht ai është në rregull: mbetet fatura, pagesa është tërhequr.

E bëja për ty, më thoshte gjithmonë mamaja. Ia ktheja paratë që të mos zhdukej fare.

Prindërit ndahen ndërsa unë shkoj të jetoj me gjyshërit. Për vite me radhë, deri në gjimnaz.

Në lidhje me marrëdhënien mes prindërve dhe fundit të martesës metabolizoj versionin e familjes së mamasë: ajo ishte e mira, ai fajtori. E vërtetë, e pavërtetë: sipas rastit, nëse duhet, ndryshoj mendim.

Mami dhe babi, tashmë jetët tona puqen vetëm në raste festash ose sipas vendimit të gjykatës. Më shumë ju përfytyroj sesa ju shoh.

Dashuria e prindërve u bë një postulat, vazhdimësia e vetmisë sime.

Mami, babi: ju kam parë bashkë vetëm kur xhaxhi Mario, vëllai i nëna Nuçës, më rrëzoi dhe përplasa fytyrën në dysHEME, kur më ngriti që të më rrotullonte në ajër. Më kapi nga krahët dhe filloi të më vërtiste rreth vetes: i rrëshqitën duart dhe përplasa hundën te pllakat kafe.

O Zot sa shumë gjak, hemorragji.

Më çojnë në banjë, ma vënë fytyrën në ujë të ftohtë. Mendojnë se kam thyer hundën, prandaj shkojmë bashkë - unë, mami dhe babi - në spitalin në qendrën e Milanos, ku doktori më fut njëfarë pince, lart, lart - prapa ballit?, arriti deri në tru? - dhe pastaj thotë: s'ka gjë, nuk ka thyerje të kockës. Pas spitalit shkojmë të hamë mëngjes në lokal, është ditë speciale - ditë feste? Shpresoj të bashkoheni prapë, atje, në atë çast, pas mëngjesit në rrugën "XXIV Maj". Mami dhe babi, përsëri të dashuruar.

Por kthehemi në shtëpi të ndarë.

Unë me mamin, babi më vete.

Asgjë nuk ka ndryshuar.

Në kopsht vazhdoja të bëja nga dy punime shtëpie, jo vetëm një, si gjithë të tjerët.

Edukatore, pse ai bën dy?

Shkoj të jetoj te gjyshërit sepse mamaja fillon punë. E marrin në një firmë pastrimesh. Zyra, por më pas edhe studiot e televizioneve të Mediaset-it - ose Fininvest, si quhej asokohe - në Kolonjo Monceze. Shefi i saj është adhurues i Berluskonit: kur hyn në politikë në '94-ën, është kandidat edhe pronari i firmës ku punon mami. Ua prish mendjen të gjithë punonjësve: të gjithë luajnë mendsh për Kavalierin - *Mami, pse e quajnë ashtu?*

Mami punon në televizion, më sjell edhe autografin e Gabibbo-s.

Njeh *velinat*, mbledh pecetat higjienike të Cristina D'Avena-s.

Është pak më shumë se njëzet vjeçe, ka mbetur vetëm: fillon të bëjë gjithçka që ia kishin ndaluar deri atëherë. Nuk kishte paguar ndonjëherë fatura, nuk e dinte çfarë ishte një llogari rrjedhëse. E mbetur pa burra, mamaja u bë kryefamiljare pa pasur më familje.

I bën të gjitha vetë, por për t'i bërë duhet të më qëndrojë larg.

Nuk më lë asgjë mangët, por më mungon çdo gjë.

Punon sa të mundet, kursen para. Ka frikë se nuk do të mjaftojnë. Nuk është mësuar t'i menaxhojë, nuk di sa mund t'i duhen. Qiraja, ushqimet, rrobat për mua që rritem çdo ditë. Është e shqetësuar: u kërkon përgjegjësve të punojë disa orë më shumë. Ata ia vënë veshin, edhe më shumë seç duhet.

Del nga shtëpia në pesë të mëngjesit, kthehet në tetë të darkës, në nëntë.